RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Xhevdet Bushi, ***Eksperti shqyrtues i jashtëm***	**22.04.2022**	**03.05.2022**	Nr. i lëndës: **109/22**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 20.04.2022, OE "SKYFTERAT LIVE" SHPK – Ferizaj, ka parashtruar ankesë me nr: **109/22**, kundër Njoftimit mbi Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Sigurimi fizik i objekteve të KQZ-së"** me nr te prokurimit**: 320-22-746-2-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**, lloji i kontratës: **Sherbime**, vlera e parashikuar e kontratës: **36,000.00 €**.

SHENIM: (Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i **OSHP-së)**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues..

TE DHENAT MBI AKTIVITETIN E PROKURIMIT

Njoftimi për kontratë: 15.02.2022
Hapja e ofertave: 28.02.2022 ora 13:00
Leter standarde per sqarimin e tenderit: 02.04.2022
Pergjigje Letres standarde per sqarimin e tenderit: 04.04.2022
Vendimi i AK-se: 12.04.2022
Vendimi i AK-së per Kerkesen per rishqyrtim: 15.04.2022

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE – 109/22

Shpallja e procedurës ne e-prokurim:
Dispozitat e shkeluara te AK-se
Neni 7 i LPP-se;
Neni 27 i LPP-se;
Neni 28 i LPP-se;
Neni 59 i LPP-se;
Neni 60 i LPP-se;
Neni 18 i RrUOPP-se;

Neni 41 i RrUOPP-se;
Neni 108A i LPP-së.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.
Pretendimet ankimore te OE ankues

Autoriteti Kontraktues në platformën e e-prokurimit me datën 21.02.2022 ka ngarkuar përgjigjet për pyetjet e parashtruara nga operatorët ekonomik, pasi që është parë e arsyeshme të kërkojnë informata shtesë, në mungesë të disa informatave e që kanë qenë më se të nevojshme që të arrihet krijimi dhe dorëzimi i një oferte nga ana e ofertuesëve të interesuar.

Neni 18.4 (RRUOPP) thotë:
18.4 Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratës në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre...

Në përgjigjet e dhëna nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për disa nga pyetjet e parashtruara nga ana e operatorëve ekonomik, pikërisht kanë qenë çështjet lidhur me punën e pagave të punëtorëve të cilët do të angazhohen në sigurimin fizik të objekteve, e që KQZ në këtë rast thekson se nuk është paraparë asnjë pagë e caktuar nga Autoriteti Kontraktues.

Provë: Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues të datës 21.02.2022

Me datën 02.04.2022 (ditë vikendi) Autoriteti Kontraktues përmes platformës së eprokurimit na dërgon letrën standarde për sqarimin e ofertës, ku bie në kundërshtim me përgjigjet e veta të dhëna dhe të publikuara në platformën e e-prokurimit, dhe kërkon të japim shpjegim lidhur me çështjen e pagave duke thënë se oferta jonë nuk rrespekton rregullativën për pagën minimale në Kosovë bazuar në dispozitën Neni 18.25 (RRUOPP).

Me datën 04.04.2022 ne si ofertues dhe palë e interesit sipas Nenit 4 par.1.26 (LPP) kemi dërguar përmes platformës së e-prokurimit përgjigjen tonë AK-së duke ia rikujtuar se po vepron në kundërshtim me vetë vehtën dhe përgjigjet që i ka dhënë në fazën e para tenderimit, duke ia bashkangjitur edhe disa dokumente si: Përgjigjet e AK-së, Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr.04/33 të datës 17.08.2011 dhe UA Nr.09/2017 të MPMS-së.

Provë: Letra standarde për sqarimin e tenderit (AK) dhe Përgjigje e letrës standarde (OE)
Me datën 12.04.2022 KQZ në platformën e e-prokurimit publikon vendimin e AK-së, duke anuluar tërësisht aktivitetin e prokurimit në arsyetim se Komisioni vlerësues rekomandon zyrën e prokurimit se asnjë operator

ekonomik nuk i plotëson kushtet për shpërblim me kontratë.

Në mesin e vendimit të AK-së, është edhe letra standarde për tenderuesin e eleminuar ku eleminimi i ofertës së kompanisë sonë është bërë pikërisht për një arsye e cila nuk ka qenë kërkesë e AK-së e specifikuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, poashtu edhe në kundërshtim me përgjigjet e dhëna nga AK në platformën e e-prokurimit, pra sipas AK-së ne eleminohemi sepse oferta jonë është në kundërshtim sipas Nenit 18.24 (RRUOPP) dhe Nenit 18.25 (RRUOPP), për çështjen lidhur me pagën minimale.

Neni 18.24 (RRUOPP) thotë:
18.24 Ofertat nga ofertuesit të cilët nuk kanë marrë parasysh obligimet e dispozitave të mbrojtjes se punëtoreve dhe kushteve të punës të identifikuara nga autoriteti kontraktues në dokumentet e kontratës nuk mund të konsiderohen si në përputhje me dokumentet e kontratës. Për më tepër, kur ofertuesit nuk marrin parasysh në mënyre të mjaftueshme këto detyrime në tenderët e tyre, tenderët e tyre mund të konsiderohen si jo-normalisht të ulët dhe mund të refuzohen për këtë arsye.

Pikërisht kjo dispozitë e cekur nga ana e Autoritetit Kontraktues me rastin e eleminimit të kompanisë sonë në letrën standarde për tenderuesin e eleminuar e specifikon kjartë që "Ofertat nga ofertuesit të cilët nuk kanë marrë parasysh obligimet e dispozitave të mbrojtjes se punëtoreve dhe kushteve të punës të identifikuara nga autoriteti kontraktues në dokumentet e kontratës nuk mund të konsiderohen si në përputhje me dokumentet e kontratës."

Pra askund në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë nuk janë të "identifikuara" dispozitat e mbrojtjes së punëtorëve dhe kushteve të punës e hiq më pak janë cekur pagat apo ndonjë ligj tjetër ku ne si operator kemi mundur të marrim udhëzime, por përkundrazi nga AK kemi marr përgjigje se çështjet lidhur me pagat minimale dhe rrespektimit të Ligjit të Punës apo Udhëzimit Administrativ lidhur me pagën minimale dhe orët e punës nuk janë përcaktuar dhe janë përgjegjësi e OE-së, dhe se në lidhje me analizën financiare thekson AK që nuk është kompetencë e jona..

Andaj eleminimi i kompanisë sonë është e padrejtë dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së dhe Rregullave e Udhëzuesit Operativ të LPP-së.

Neni 41.11 dhe 41.12 (RRUOPP) thotë:
41.11 Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkese apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.

41.12 AK do t'i vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kritereve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.

Andaj marr parasysh se oferta jonë ka plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë si dhe duke u bazuar në sqarimin e dërguar tek AK duke dhënë kalkulimin e saktë se kompania jonë ka ofertuar duke rrespektuar rregullatoren në lidhje me orët e punës për punëtorët e angazhuar në jo më shumë se 176 orë të lejuara sipas UA Nr.09/2017 të MPMS-së edhe pse ska qenë kërkesë e specifikuar, si dhe një fitim minimal të mundshëm duke përfshirë të gjitha taksat, konsiderojmë se jemi oferta më e lirë e përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit.

Autoriteti Kontraktues shihet se ka vepruar poashtu në kundërshtim me Nenin 7 (LPP) me rastin e paraqitjes së kërkesave tek OE pjesëmarrës për sqarimin e tenderit, pasi që edhe në vendimin e AK-së të publikuar me datë 12.04.2022 ka cekur se kompanisë "Luani" nuk i ka kërkuar sqarime, e që në këtë rast ka përdor standarde të dyfishta, sepse nuk mund të merret arsyetim se ka qenë e panevojshme për shkak se i njejti ka qenë i papërgjegjshëm, pikërisht dispozita e lartëcekur Neni 7 e LPP-së flet për trajtim të barabartë dhe jo diskriminim.

Neni 4.1 (RRUOPP) thotë: 4.1 AK gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit janë të obliguar të marrin masa të nevojshme për të siguruar trajtim të barabartë dhe jo-diskriminim në mesin e Operatorëve Ekonomik.

Autoriteti Kontraktues (KQZ) ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Nenit 44.5 dhe 44.6 (RRUOPP) me rastin e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit, pasi që nuk ekzsiton asnjë arsyetim i cekur, dhe se oferta jonë është ofertë e përgjegjshme duke plotësuar të gjitha kërkesat e specifikuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, si dhe oferta jonë nuk e tejkalon buxhetin e AK-së të parashikuar.

Andaj bazuar në të gjitha argumentet e lartëcekura kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që kërkesën tonë për rishqyrtim të Aprovoj të bazuar dhe të korrigjoj vendimin e AK-së duke na shpallur fitues të kësaj kontrate marr parasysh se jemi oferta më e lirë e përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën do të detyrohemi që ankesën ta vazhdojmë edhe në organet më të larta vendim marrëse (OSHP) dhe (Gjykatë) kundrejt kësaj padrejtësie që po na bëhet me rastin në fjalë.

DEMET MATERIALE

Shkeljet e supozuara na kërcënojnë të na shkaktojnë dëme materiale duke na pamundësuar nënshkrimin e kontratës dhe humbjen e fitimit të paraparë të kësaj kontrate si dhe shpenzimet e përgatitjes së ankesës, depozitën etj.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dështmia e kërkuar dokumentare*:
a. Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04 L-042, Neni 65. b. Një dokument nga Administrata Tatimore e vendit	**a. Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit, Aneksi 2(Origjinal). b.Vërtetimin nga**

tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës. c. Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë"- të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës.	**Administrata Tatimore (kopje). c.Vërtetimin nga Gjykata Themelore- Departamenti për Çështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit). Dokumentet (nën b dhe c) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues. Në rast të dështimit në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar të radhës.**
Profesionalna podobnost **1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; 2. Regjistrimi i TVSH; ne vendin e themelimit 3. Regjistrimi i numrit fiskal**	*Dështmia e kërkuar dokumentare:* **1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend Kopja e certifikatës së biznesit); 2. Kopja e certifikatës TVSH-se; 3. Kopja e certifikatës numrit fiskal**
Kapaciteti ekonomik dhe financiar	*Dështmia e kërkuar dokumentare:*
Kapaciteti teknik/profesional **a. Një listë të kontratave te perfunduara, e nënshkruar dhe vulosur nga OE, per sherbime te njejta për periudhën e shkuar trevjeçare deri ne publikimin e Njoftimit për Kontratë.**	*Dështmia e kërkuar dokumentare:* **a. Një listë të kontratave te perfunduara, e nënshkruar dhe vulosur nga OE, per sherbime te njejta për periudhën e shkuar trevjeçare deri ne publikimin e Njoftimit për Kontratë, duke bashkëngjitur referencat te këtyre kontratave, se paku 3 referenca te ketyre kontratave.**
b. Deklaratë me shkrim e nenshkruar dhe e vulosur për përmbushjen e specifikave teknike aneksi 1 te dosjes se tenderit.	**b. Deklaratë me shkrim e nenshkruar dhe e vulosur për përmbushjen e specifikave teknike aneksi 1 te dosjes se tenderit.**
c. Licenca per kryerjen e sherbimeve te sigurimit te objekteve te leshuar nga institucioni kompetent ne Republiken e Kosoves	**c. Licenca per kryerjen e sherbimeve te sigurimit te objekteve te leshuar nga institucioni kompetent ne Republiken e Kosoves**
d. Dëshminë për licencimin e te gjithë punëtorëve te kompanisë (kopjet e licencave dhe te certifikatave te trajnimit te punëtoreve te sigurimit)	**d. Dëshminë për licencimin e te gjithë punëtorëve te kompanisë (kopjet e licencave dhe te certifikatave te trajnimit te punëtoreve te sigurimit)**

Kriteret e kerkuara nga AK-ja (per pretendimet qe ka OE ankues):

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni ri-vlerësues ka konstatuar si në vijim:
Filloi N/A
Perfundoi N/A
(Të përshkruhet vetëm vlërësimi i ofertës së OE ankues / ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

- ***Komisioni i vleresimit:***
- Haki Krasniqi – kryesues,
- Kreshnik Spahiu – Anetar dhe
- Mergita Kryeziu – Anetare

Rekomandon qe te anulohet aktiviteti, pasi qe nuk eshte bindur me sqarimet e pranuara nga OE-te lidhur me pagen, dhe vijne ne perfundim qe te perseritet aktiviteti dhe ne dosje te percaktohen me sakte sipas Ligjit dhe UA (MPMS) nr.09/2017 lidhur me oret e nates, festave, pushimeve vjetore etj.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA ANA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

--

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet njëvlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

- **NA**

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

PERGJIGJE NE PRETENDIMET ANKIMORE TE OE ANKUES: 109/22

Pergjigje ne pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, Autoriteti Kontraktues në platformën e e-prokurimit me datën 21.02.2022 ka ngarkuar përgjigjet për pyetjet e parashtruara nga operatorët ekonomik, pasi që është parë e arsyeshme të kërkojnë informata shtesë, në mungesë të disa informatave e që kanë qenë më se të nevojshme që të arrihet krijimi dhe dorëzimi i një oferte nga ana e ofertuesëve të interesuar.

Neni 18.4 (RRUOPP) thotë:
18.4 Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratës në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre...

Në përgjigjet e dhëna nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për disa nga pyetjet e parashtruara nga ana e operatorëve ekonomik, pikërisht kanë qenë çështjet lidhur me punën e pagave të punëtorëve të cilët do të angazhohen në sigurimin fizik të objekteve, e që KQZ në këtë rast thekson se nuk është paraparë asnjë pagë e caktuar nga Autoriteti Kontraktues.

Provë: Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues të datës 21.02.2022

AK – KQZ ka dhënë këtë përgjigje

Lenda Sqarimet nga KQZ në kërkesën për Pyetje shtesë që OE e interesuar i kane bere AK-se

Pyetje	**Pergjigje nga AK-ja**
-Ju lusim te na dërgoni adresën e sakte ku parashihet te sigurohet objekti me orarin 24/7?	-Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, Zona Industriale Fushë Kosovë, 10000, Prishtinë, si dhe objekte tjera nëse do te ketë nevoje.
- Ne dosje te tenderit, te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika d. Keni kërkuar "Dëshmitë për licencimin e te gjithë punëtoreve te kompanisë (kopjet e licencave dhe te certifikatave te trajnimit te punëtoreve te sigurimit) Ju lusim te na e konfirmoni se a behet fjale për katër (4) punëtoret qe parashihet te angazhohet ne ketë projekt?	- Behet fjale për punëtoret qe do e mbulojnë piken ne fjale qofshin ata 4 ,5 ose edhe me shume, edhe kur I ndërroni mjafton te kemi listën e tyre apo edhe për ndryshime do te jeni ne kontakt me Menagjerin e projektit.
- Vlera e projektit eshët 30,508.47€ pa TVSh për 36 muaj, apo 847.45€ pa TVSh për 1 muaj, qe nënkupton se me ketë shume/vlere duhet te paguhen punonjësit e angazhuar ne ketë projekt, shpenzimet tjera qe rrjedhin nga	-Buxheti është i parapare dhe i aprovuar ne ketë vlere duke përfshire te gjitha taksat.

realizimi i shërbimeve dhe fitimi i kompanisë!	
-A keni mundësi buxhetore pre rritjen e kësaj vlere, duke pasur parasysh numrin e punëtoreve dhe shpenzimet tjera si te cekura me larte ne piken 3.?	-Jo, është planifikuar dhe e aprovuar vlera .
-A e keni përcaktuar numrin e punëtoreve qe parashihet te angazhohen ne ketë projekt, apo eshët nen përgjegjësinë e OE te bej përcaktimin e numrit te punëtoreve?	-Është ne përgjegjësi te OE.
-A ka page minimale te përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues, apo duhet respektohet paga minimale ne nivel nacional prej 170.00€ Bruto?	Nuk është përcaktuar paga minimale nga AK.
-A obligohet O.E nga AK te beje respektimin e ligjit te punës duke përfshire: pagesën shtese për punën e natës, pagesën shtese për te gjitha orët sipas UA (MPMS) nr.09/2017, pagesën shtese për orët e vikendeve dhe festave, pagesën e pushimit vjetor, pagesën e pushimit mjekësor? Apo respektimi i ligjeve ne fuqi mbetet ne përgjegjësinë e O.E pjesëmarrës dhe nuk është pjese e vlerësimit?	Eshte pergjegjesi e OE-se
-A kërkohet te dorëzohet Analiza Financiare se si OE kane ardhur deri tek çmimi i ofertimit?	-Jo nuk është kompetenca e jona.

Pergjigje ne pretendimin nr.2

Lidhur me sqarimin qe AK u ka kerkuar OE-ve ne dite vikendi, mendoj se eshte e padrejte ti kerkohet sqarime ne dite vikendi (e shtune, e diel). Por, obligim i AK-se eshte ti dergoj qofte sqarime, apo dokumente shtese brenda orarit te punes E Hane – E premte (08:00 deri 16:00).
Pretendimi ankimor i OE ankues eshte i bazuar ne kete pike!

Pergjigje ne pretendimin nr.3

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, se AK nuk e ka kerkuar pagen minimale, dhe poashtu nuk e ka kerkuar Analizen Financiare ne sqarimet qe i kane kerkuar OE gjate fazes se tenderimit, por

mendoj se eshte pergjegjesi e OE –ve, qe te respektojne Ligjin e punes 03/L-212 qe te respektohet ky ligj ne teresi si psh. per: oret e kujdestarisë 20%, orët e nates 30%, oret e festave 50%, puna gjate fundjaves 50%, puna jashte orarit te punes 30% etj, qe sipas ligjit jane te obliguar OE ti paguajne per punetoret sipas nenit 56 te Ligjit nr.03/L-212 poashtu edhe neni 57 i ketij Ligji, qe e percakton pagen minimale sipas KSE-se, poashtu ne kete ligj percaktohen edhe pushimet mjekesore, pushimet vjetore qe duhet te respektohen per çdo te punesuar. Per kete pike mendoj se AK duhet ti kerkoj sqarime OE-ve lidhur me Ligjin e Punes nr.03/L-212 dhe UA(MPMS) nr.09/2017.
Pra, eshte pergjegjesi e OE-se ta respektoj Ligjin e Punes per te punesuarit, poashtu edhe pergjegjesi e komisionit te vleresimit te AK-se te bej nje analize lidhur me çmimin ofertues, psh nese çmimi eshte 1 €/ora x 176 orë (muaj) = 176.00 € apo nese çmimi eshte 1.12 €/ora x 176 ore (muaji) = 197.12 €, ku ne kete çmim duhet te kalkulohen oret e festave, nates, oret jashte orarit, pushimet vjetore etj. Pra OE me kete page a i ka kalkuluar oret e festave, nates, jashte orarit, pushimet vjetore etj sipas Ligjit te Punes apo Jo?
Pra, pretendimi ankimor i OE ankues, eshte pjeserisht i bazuar dhe AK duhet ti kerkoj sqarime shtese sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se, per zbatimin e Ligjit te Punes nr.03/L-212 dhe UA nr.09/2017 te MPMS-se nga Operatoret Ekonomik ofertues.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna me larte), eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues qe ankesa e OE-së të aprovohet pjeserisht e bazuar dhe lenda te kthehet ne rivleresim dhe gjate rivleresimit AK ti kerkoj sqarime OE ofertues sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se, per zbatimin e Ligjit te Punes nr.03/L-212 dhe UA nr. 09/2017 ne pagat e te punesuareve.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **AK-KQZ**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues - **OE."SKYFTERAT LIVE"- Ferizaj**